

Strategjia e kalimit ne transmetimet numerike, forma dhe menyra e realizimit

- Në Shqipëri u punua për një kohë relativisht të gjatë për finalizimin e Strategjisë për kalimin në transmetimet numerike. Në vitin 2008 Kryeministri, krijoi një Komitet *ad hoc* "për hartimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato dixhitale".
- Dokumenti final i Strategjisë së Kalimit u miratua nga Këshilli i Ministrave në 2 Maj 2012. Së bashku me Strategjinë u miratua edhe Plani i Veprimit për Implementimin e Strategjisë, që parashikon masat për realizimin e kalimit të plotë brenda 17 Qershorit 2015.
- Strategjia e dixhitalizimit merr persiper zgjidhjen e problemeve kryesore që te sigurojë një sistem të qëndrueshëm të medieve elektronike si financimi i kalimit nga transmetimet analoge në ato dixhitale dhe lehtësirat për operatorët e përdoruesit, sigurimi i Shërbimit të Transmetimi Publik efikas, trajtimi i operatorëve kombëtarë e lokalë, organizimi i garave për për dhënien e licencave, skemat e licencimit/autorizimit, teknologjia e rrjetit dhe sistemi i kompresimit, organizimi i informimit të publikut gjatë periudhës transitore, etj.

Strategjia dhe procesi i dixhitalizimit

- Dixhitalizimi ka potencialin të ofrojë më shumë mundësi për pluralizëm dhe diversitet në fushën e transmetimeve, pasi spektri lejon më shumë përdorues sesa sistemi analog. Megjithatë, dixhitalizimi i vetëm nuk mund t'i zgjidhë problemet e lirisë së medias, piraterisë dhe ndërhyrjeve politike në fushën e medias. Përkundrazi, sidomos në fazat e hershme, dixhitalizimi përmban edhe risqe si monopolizimi apo cementimi i problemeve ekzistuese në fushën e transmetimeve.
- Strategjia përcakton se digjitalizimi do të implementohet qark pas qarku (ose, allotment për allotment), sipas metodës së njohur si “Digital islands” (ishujt dixhitalë). Është një metodë e aplikuar nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Por po të kemi parasysh afatin e përcaktuar në mes të vitit 2015, është e qartë se nuk mbetet shumë kohë për ta filluar procesin në Shqipëri.

Shfrytëzimi i kapaciteteve të Planit Numerik

- Sipas strategjisë, shfrytëzimi i kapaciteteve të vena në dispozicion të Shqipërisë nga Marrëveshja GE 06, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, paraqitet në tabelën e mposhtëme:

Nr.	Klasifikimi	Zona e mbulimit	Numri i mbulimeve të planit kombëtar të shfrytëzuara	Numri i rrjeteve që mund të krijohen	Tipi i rrjetit
1	Operatori Publik Kombëtar	Territori i Republikës	2	2	11 SFN
2	Operatorë Kombëtarë Privatë	Territori i Republikës	3	3 ^[1]	11 SFN
3	Operatorë Vendorë	1 Qark	1	11	SFN
5	Rezervë	Territori i Republikës	2	2	11 SFN
	Mbulime Kombëtare gjithsej		8	22	SFN+MFN
6	Operatorë të qytetit të Tiranës	Qyteti i Tiranës dhe rrethinat	1	7	SFN

Shfrytëzimi i mbulimeve kombëtare të Planit të Frekuencave numerike të Shqipërisë

[1] Ne varesi të zhvillimeve sipas seksionit 2.2, kapacitetet e lira në përfundim të procesit të licensimit mund të shfrytëzohen për ndërtimin e rrjeteve rajonale.

Karakteristikat teknike

Tipet e rrjeteve

- Plani kombëtar i frekuencave parashikon ndarjen e territorit të Shqipërisë në 11 allotmente.
- Për shfrytëzimin optimal të kapaciteteve të krijuara nga plani kombëtar i frekuencave, propozohet që secili allotment i planifikuar, të mbulohet nga një rrjet me frekuencë të vetme (SFN- Single Frequency Network). Për krijimin e mbulimeve më të mëdha së një allotment, do të kombinohen dy ose më shumë SFN. Për krijimin e një rrjeti kombëtar, kërkohet kombinimi i SFN-ve të 11 allotmenteve, pra do të krijohet një rrjet MFN (Multi Frequency Network), pra tipi i rrjetit do të jetë 11 SFN.

- Duke i u referuar tabelës së mësipërme, në territorin e Shqipërisë do të ndërtohen:
- 2 Rrjete 11 SFN kombëtarë për TV publik
- 3 Rrjete 11 SFN kombëtarë për operatorët privatë kombëtarë
- 11 Rrjete SFN lokalë për operatorët privatë lokalë
- 2 mbulime kombëtarë mbeten rezervë.

Sistemi i transmetimit

- Duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, mundësitë e përfitimit ekonomik dhe përdorimit me efektiv të spektrit të frekuencave që ato ofrojnë, zhvillimet në vendet e tjera, si dhe lirinë e brezit të DD, dokumenti i strategjisë përcakton që Shqipëria të kalojë direkt në implementimin e sistemit më të avancuar **DVB-T2**.

Standardet e kompresimit

- Në rrjetet numerike tokësore që do të ndërtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë do të aplikohet sistemi i kompresionit **MPEG-4**. Kjo do të lejojë shfrytëzimin me efektivitet të spektrit, si dhe programet HD.
- Duke qenë se operatorët ekzistues të rrjeteve numerike tokësore (të pa licencuar) aplikojnë standardin MPEG 2, do të caktohet një periudhë tranzicioni MPEG2/MPEG-4, (jo më shumë se 2 vjet).

Licencimi

- Mjedisi i transmetimeve dixhitale dhe procesi i kalimit nga transmetimet analoge në dixhitale duhet të ketë **një bazë të fortë ligjore** që përmban siguri dhe garanci për interesin publik, akses në informacion dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit. Një bazë e tillë ligjore do të të sigurohet nga ligji i ri “Për transmetimet audiovizive” që po shqyrtohet nga Parlamenti për të cilin do flitet në vijim.
- Ndërkohë, KKRT po punon për hartimin e rregulloreve specifike që do të mbështetin zbatimin e ligjit të ri menjëherë sapo ky i fundit të miratohet nga Kuvendi.
- Në strategjinë e miratuar janë përcaktuar mënyrat e licencimit, autorizimit të rrjeteve dhe shërbimeve audiovizive, të cilat janë reflektuar edhe në ligjin e ri që pritet të miratohet së shpejti.

FALEMINDERIT!